

Dr. Gazmend Zeneli ka rreth 25 vite experiencë në punën kërkimore, shkencore dhe mësimdhënie. Ai mban gradën **Doktor i Shkencave** (Dr. rer. nat.) nga Universiteti Friedrich Schiller në Jena (Gjermani) pas disa vitesh pune kërkimore në Max Planck Institute for Chemical Ecology po në Jena (Gjermani) dhe Master i Shkencave (M.Sc), në shkencat e mjedisit nga Instituti Agronomik Mesdhetar i Chania-se (Greqi). Gjatë kësaj periudhe Dr. Zeneli ka punuar në disa nga qendrat më të rëndësishme kërkimore apo Universitare ndërkombëtare, si: Max Planck Institute for Chemical Ecology; Technical University of Dresden; Leibniz Institute of Ecological Regional Development, etj.

Përvojat e tij në menaxhim janë të shumta: nga drejtues projekti dhe menaxher i projekteve të ndryshme deri në Drejtor i Institutit për Kërkim dhe Zhvillim “Barleti”, dhe nga drejtues departamenti deri në Dekan Fakulteti.

Fitues i disa granteve për hulumtime dhe pjesëmarrje në konferenca, ai ka botuar mbi 35 artikuj shkencorë. Rezultatet e aktivitetit të tij shkencor janë publikuar në disa nga revistat më të njohura në fushën e mjedisit dhe në disa libra. Po ashtu këto rezultate janë prezantuar në mbi 45 konferenca ndërkombëtare në të gjithë botën. Ai është një ndër studiuesit shqiptarë më të cituar të fushës së mjedisit me rreth 500 citime dhe treguesin e Hirshit (h-index) 8.

Dr. Zeneli është certifikuar si ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Auditimin Mjedisor nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë dhe si mësim-dhënës në fushën e turizmit (Certified Hospitality Educator) nga Instituti Arsimor Amerikan i Hoteleri Turizmit (AHLEI) dhe flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe atë gjermane.

Ai është lektor i disa lëndëve në programet e Studimit Bachelor dhe Master në SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” dhe është Lektor i Ftuar i Universitetit të Evropës Juglindore të Tetovës (Maqedonia e Veriut dhe Universitetit të Arkansas, Clinton School of Public Service (SHBA).